



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



**DRAFT-RREGULLORE NR. __/2024 PËR LICENCIMIN DHE
KUSHTET E LICENCËS PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË UJIT
NË KOSOVË**

Nëntor 2024

Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit,
Në përputhje me nenin 4, nënparagrafin 3.6, lidhur me nenin 18 paragrafin 2 dhe nenin 47 paragrafin 3, të Ligjit Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 4/14 Janar 2016,

Nxjerr:

RREGULLORE NR. ___/20204
PËR LICENCIMIN E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE
TË UJIT DHE KUSHTET E LICENCËS SE SHËRBIMIT

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregullore është të përcaktojë procedurat dhe kriteret e licencimit si dhe të definojë kushtet e licencës për ofruesit e shërbimeve të ujit në Republikën e Kosovës. Rregullorja krijon një proces transparent dhe të barabartë për dhënien, përtëritjen dhe vazhdimin e licencave, duke siguruar që ofruesit e shërbimeve të përmbushin standardet e nevojshme për ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të qëndrueshme. Për më tepër, kjo rregullore siguron një kornizë të qartë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për këtë sektor.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Dispozitat e kësaj rregullore janë të detyrueshme për Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit, për ofruesit e shërbimeve dhe për të gjithë aplikuesit për licencë të shërbimeve të ujit, si dhe për çdo zyrtar tjetër ekskluzivisht të përmendur në këtë Rregullore.
2. Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (të quajtur më tej "Autoriteti") është përgjegjës për përcaktimin e të drejtave, obligimeve dhe kushteve të licencës për shërbime. Autoriteti ka detyrim ligjor të sigurojë që ofruesit e shërbimeve të ujit të veprojnë në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e përcaktuara në licencën e shërbimit.

Neni 3
Përkufizimet

1. Fjalët dhe shprehjet e përdorura në këtë Rregullore do të kenë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **Aplikues** - çdo person juridik që aplikon për tu pajisur me licencë shërbimi.
 - 1.2. **Autoriteti** - Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) si autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit në Kosovë;

- 1.3. **Drejtues teknik** - nënkupton një udhëheqës apo menaxher të departamentit teknik që ka diplomë universitare në drejtimin e inxhinierisë dhe që ka përvojë pune prej të paktën pesë (5) vite në sektorin e shërbimeve të ujit;
- 1.4. **Licencë e shërbimit** - leja e lëshuar nga Autoriteti me të cilën jepet autorizimi për ofrimin e shërbimeve të ujit;
- 1.5. **I licencuar** - personi juridik që mban një licencë të dhënë nga Autoriteti për të ofruar shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizuesit të ujit me shumicë;
- 1.6. **Marrëveshje e shërbimit** - marrëveshja e nënshkruar nga Komuna dhe ofruesit e shërbimeve nën kontrollimin dhe mbikqyrjen e Autoritetit, për ofrimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura brenda komunës së veçantë, në të cilën janë të përcaktuara të drejtat dhe obligimet e të dy palëve;
- 1.7. **Ofruesi i shërbimeve** - çdo ofrues i shërbimeve të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizuesit të ujit me shumicë;
- 1.8. **Shërbimet e ujësjellësit** - marrja, përpunimi dhe shpërndarja e ujit për konsum njerëzor si dhe operimi i rrjetit dhe objekteve për atë qëllim;
- 1.9. **Shërbimet e ujërave të ndotura** - grumbullimi, bartja, trajtimi dhe shkarkimi i ujërave të ndotura të përdorura nga shfrytëzuesit shtëpiak, komercial, industrial dhe publik;
- 1.10. **Shërbimet e ujit** - shërbimet e ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizimi i ujit me shumicë;
- 1.11. **Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar** - shërbim i ujit të mbledhur, ose të ekstraktuar i cili si i papërpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.12. **Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar** - shërbim për ujin e mbledhur, ose të ekstraktuar i cili si i përpunuar furnizohet si ujë me shumicë;
- 1.13. **Zona e shërbimit** - zona e shërbimit e cila është përcaktuar me aktin nënligjor të miratuar nga Qeveria e Kosovës,
2. Përkufizimet / shprehjet tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

Neni 4

Kategoritë dhe rregullat e licencimit për ofruesit e shërbimeve të ujit

1. Autoriteti ka kompetencën për të lëshuar licenca për ofruesit e shërbimeve të ujit për kategoritë e mëposhtme:
 - 1.1. **Kategoria A: Shërbimet e Ujësjellësit**. Nënkupton të gjitha aktivitetet dhe shërbimet që lidhen me furnizimin e ujit të pijshëm për konsumatorë; përfshirë marrjen, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit në rrjetin e ujësjellësit, si dhe operimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e gjithë infrastrukturës që mbështet këtë shërbim.
 - 1.2. **Kategoria B: Shërbimet e Kanalizimit**. Nënkupton ofrimin e shërbimeve që ndërlidhen me grumbullimin, bartjen dhe shkarkimin e ujërave të ndotur në mjedis; përfshirë operimin,

mirëmbajtjen dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit dhe objekteve tjera që mbështesin këtë shërbim.

- 1.3. **Kategoria C: Shërbimet e Ujërave të Ndotura.** Nënkupton ofrimin e shërbimeve që lidhen me grumbullimin, bartjen, trajtimin, shkarkimin apo ripërdorimin e ujërave të ndotur të përpunuar (efluentëve), përfshirë operimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës që mbështet këtë shërbim.
 - 1.4. **Kategoria D: Shërbimet e Ujit të Papërpunuar me Shumicë.** Nënkupton ofrimin e ujit të papërpunuar me shumicë për përdorim nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit si dhe operimin, mirëmbajtjen e infrastrukturës që mbështet këtë shërbim.
 - 1.5. **Kategoria E: Shërbimet e Ujit të Përpunuar me Shumicë.** Nënkupton ofrimin e shërbimeve të ujit me shumicë që është përpunuar për të arritur standardet e kërkuara për pije. Ky shërbim përfshinë marrjen, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm; përfshirë operimin, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e infrastrukturës që mbështet këtë shërbim.
2. Asnjë ofrues shërbimesh nuk mund të ofrojë shërbime të ujit sipas kategorive të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, pa u pajisur me licencë shërbimi nga Autoriteti.
 3. Ofruesit e shërbimeve të ujit të kategorisë D, siç specifikohet në paragrafin 1.4, të këtij neni, zbatohet për ofrimin e ujit me shumicë vetëm për ofruesit e shërbimeve të licencuar nga Autoriteti.
 4. Ofruesit e shërbimeve të ujit të Kategorisë E, siç specifikohet në paragrafin 1.5 të këtij neni, mund të ofrojnë shërbime të ujit me shumicë për subjektet e autorizuar, vetëm pas marrjes së miratimit paraprak me shkrim nga Autoriteti. Përdoruesit e këtij shërbimi duhet të zbatojnë në plotni tarifat e shërbimit të miratuara nga Autoriteti.
 5. Licencimi për aktivitetet e përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni do të bazohet në kritere të qarta, të paanshme dhe transparente.

KAPITULLI II

PROCEDURAT DHE ADMINISTRIMI I PROCESIT TË LICENCIMIT

Neni 5

Kompetencat e Autoritetit për mbikëqyrjen e procesit të licencimit

1. Autoriteti është i vetmi institucion në Republikën e Kosovës që ka përgjegjësinë për të pranuar dhe shqyrtuar aplikacionet për licencim të ofruesve të shërbimeve të ujit, duke siguruar që këto aplikacione shqyrtohen në mënyrë objektive, transparente dhe jodiskriminuese.
2. Pas shqyrtimit dhe vlersimit të aplikacionit, Autoriteti ka kompetencën për të aprovuar ose refuzuar kërkesën për licencim.
3. Autoriteti angazhohet për përmirësimin dhe optimalizimin e vazhdueshëm të procedurave dhe praktikave të licencimit.

Neni 6

Aplikimi për licencë të shërbimit

1. Çdo person juridik i regjistruar në organet shtetërore kompetente të Republikës së Kosovës, që ka si aktivitet primar ofrimin e shërbimeve të ujit, ka të drejtën të aplikojë për licencë shërbimi.
2. Aplikacioni për licencim duhet të përfshijë:
 - 2.1. Kërkesën për licencim;
 - 2.2. Formularin e plotësuar me të dhënat për licencim, të bashkangjitur në shtojcën 2 dhe 3 të kësaj Rregullore, dhe
 - 2.3. Dokumentet e kërkuara, sipas listës në shtojcën 1 të kësaj Rregullore.
3. Para dorëzimit tek Autoriteti, aplikacioni për licencë shërbimi duhet të aprovohet nga organi më i lartë drejtues i aplikuesit (ofruesit të shërbimeve), i cili organ e autorizon personin përgjegjës që merret me procesin e licencimit.
4. Aplikuesi duhet të dorëzojë tek Autoriteti aplikacionin në tri (3) kopje të shtypura (një origjinal dhe dy kopje) dhe një (1) kopje elektronike në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Aplikuesi duhet të përmbushë të gjitha kërkesat dhe dokumentet të përcaktuara në shtojcat 1, 2 dhe 3 për licencim për herë të parë, ndërsa shtojcat 1, 2 dhe 4 përdoren për përtëritje / vazhdim apo ndryshim të licencës.
6. Aplikacioni do të refuzohet nëse dokumentet dhe formularët nuk janë në përputhje me kërkesat e specifikuar në këto shtojca.

Neni 7

Procedura për shqyrtim të aplikacionit

1. Autoriteti shqyrton aplikacionin e paraqitur për lëshimin, përtëritjen apo ndryshimin e licencës për shërbime brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve, pas pranimit të aplikacionit. Ky afat mund të shtyhet në pajtim me rregullat e përcaktuara në Ligjin përkatës për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
2. Nëse aplikacioni i dorëzuar nuk është i kompletuar, Autoriteti do të kërkojë nga aplikuesi që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve të ofrojë informacionet dhe dokumentet e nevojshme për ta kompletuar aplikacionin.
3. Në rast se aplikuesi nuk e korrigjon aplikacionin ose nuk dorëzon dokumentet e nevojshme brenda periudhës së caktuar në paragrafin 2 të këtij neni, Autoriteti do të marrë një vendim me shkrim bazuar në dokumentet e dorëzuara, përmes të cilit do të njoftohet aplikuesi.
4. Ofruesit e licencuar të shërbimeve mund të kërkojnë nga Autoriteti përtëritjen ose ndryshimin e licencës për shërbime vetëm atëherë kur:
 - 4.1. Licenca për shërbime parasheh përtëritjen;
 - 4.2. Ka ndryshim të zonës së mbulimit me shërbime të ofruesit të shërbimeve;

4.3. Ofruesi i shërbimeve iu ka përmbajtur kushteve të licencës për shërbime në të gjitha aspektet materiale; dhe

4.4. Aplikacioni është paraqitur së paku tre (3) muaj para datës kur skadon licenca për shërbime.

Neni 8

Kohëzgjatja e validitetit të licencës për shërbime

Licenca për shërbime i lëshohet ofruesve të shërbimeve për periudhën jo më të shkurt se një (1) vit dhe jo më gjatë se dhjetë (10) vjet. Procedura e lëshimit të licencës sipas këtij neni, duhet të jetë në përputhje me nenin 7 paragrafin 1, të kësaj rregullore.

Neni 9

Lëshimi i licencës për shërbime

1. Licenca e shërbimit, përtëritja dhe ndryshimi i licencës, i lëshohet aplikuesit, nëse dëshmon se:

1.1. I përmbush kriteret e përcaktuara me këtë Rregullore;

1.2. Disponon resurse të mjaftueshme ujore për të furnizuar zonën e shërbimit;

1.3. Disponon kapacitete adekuate profesionale dhe menaxhuese në fushën operative (operim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës së ujit dhe ujërave të ndotura), financiare dhe administrative;

1.4. Ka qëndrueshmëri financiare;

1.5. Pranon përgjegjësinë për ofrimin e shërbimeve të ujit përmes marrëveshjes me komunat në zonën e shërbimit të ofruesit të shërbimeve, të përcaktuara me akt nënligjor të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

1.6. I është përmbajtur kushteve të licencës së shërbimit (vlen për rastet e përtëritjes / vazhdimit dhe ndryshimit të licencës).

1.7. Ka siguruar të gjitha lejet, pëlqimet dhe autorizimet e nevojshme nga autoritetet përkatëse;

1.8. I ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga kjo Rregullore; dhe

1.9. Cilësia e ujit të pijshëm është në përputhje me standardet e shërbimeve të përcaktuara nga autoriteti kompetent për shëndetësi publike.

Neni 10

Përmbajtja e licencës për shërbime

1. Licenca e lëshuar nga Autoriteti është dokument zyrtar që autorizon ofruesit e shërbimeve për të operuar në përputhje me rregullat dhe standardet e përcaktuara. Ky dokument zyrtar përmban informacionet si më poshtë:

1.1. Emërtimi dhe adresa e Autoritetit që lëshon licencën;

1.2. Emërtimi dhe adresa e ofruesit të licencuar të shërbimeve;

1.3. Përshkrimi i shërbimeve për të cilat ofruesi është i licencuar;

- 1.4. Data e lëshimit dhe data e skadencës së licencës;
- 1.5. Zona e shërbimit në të cilën i licencuari është autorizuar të ofrojë shërbime; dhe
- 1.6. Përshkrimi i shkurtër i kushteve të licencës.

Neni 11

Ndryshimi i licencës së shërbimeve

1. Në përgjigje të çdo kërkesë nga të licencuarit ose me iniciativën e vet, Autoriteti mund të ndryshojë kushtet dhe kriteret e një licence për shërbime, atëherë kur:
 - 1.1. Ka ndryshime të rrethanave të lëshimit të licencës për shërbime (ndryshimet në ligje apo rregullore që atakojnë kushtet e licencimit);
 - 1.2. Ka ndryshime teknike ose financiare që bëjnë të pamundur plotësimin e plotë ose të pjesshëm të kushteve të vendosura për licencim;
 - 1.3. Ka ndryshime në strukturën e të licencuarit për shkak të ndarjes, bashkimit ose transformimit në një subjekt tjetër;
 - 1.4. Ka ndryshime në zonën e shërbimit, e që është në pajtim me planin e konsolidimit të aprovuar nga Qeveria e Kosovës dhe Autoriteti;
 - 1.5. Ka ndryshime në emërtimin e ofruesit të shërbimeve; dhe
 - 1.6. Nuk ka ndryshime për të përmbushur kërkesat për korigjim të shkeljeve gjatë afatit të pezullimit sipas nenit 19, paragrafi 1 (1.1. dhe 1.2.).
2. Kur Autoriteti vendos të ndryshojë një licencë për shërbime, duhet ti lëshojë të licencuarit një licencë për shërbime me përmbajtje të ndryshuar.
3. Në rastin e ndryshimit të licencës për shërbime Autoriteti zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin e parë.

Neni 12

Përtëritja / vazhdimi i licencës për shërbime

1. Ofruesi i shërbimeve mund të kërkojë nga Autoriteti përtëritjen / vazhdimin e licencës për shërbime vetëm kur plotësohen të gjitha kushtet në vijim:
 - 1.1. Nëse licenca për shërbime parasheh përtëritjen / vazhdimin;
 - 1.2. Nëse ofruesi i shërbimeve i është përmbajtur kushteve të licencës për shërbime;
 - 1.3. Nëse ofruesi i shërbimeve ka dëshmuar qëndrueshmëri financiare; dhe
 - 1.4. Aplikacioni për përtëritje / vazhdim të licencës së shërbimeve sipas shtojcës 4 të kësaj Rregulloreje është paraqitur së paku tre (3) muaj para datës kur skadon licenca për shërbime.
2. Në rastin e përtitjes / vazhdimit të licencës për shërbime, Autoriteti zbaton të njëjtat afate dhe procedura si për licencimin e parë.

Neni 13

Vendimmarrja për lëshimin e licencës për shërbime

1. Autoriteti pas shqyrtimit të aplikacionit për lëshimin, përtëritjen / vazhdimin dhe ndryshimin e licencës për shërbime, do të nxjerr vendim me shkrim në afat prej dyzetepesë (45) ditëve pas pranimit të aplikacionit. Autoriteti mund të zgjasë afatin e vendimmarrjes, në përpjestim me kompleksitetin e çështjes konkrete, por nuk mund të jetë më e gjatë se afati fillestar.

2. Nëse Autoriteti vendos që të refuzoj kërkesën e aplikuesit për lëshimin, përtëritjen / vazhdimin dhe ndryshimin e licencës për shërbime, i njëjti duhet të njoftojë aplikuesin brenda afatit të përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, përmes vendimit me shkrim për arsyet e refuzimit të kërkesës së tij, në pajtim me ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.

KAPITULLI III

OBLIGIMET DHE KRITERET PËR MENAXHIMIN E LICENCËS PËR SHËRBIMET E UJIT

Neni 14

Obligimet e të licencuarit

1. I licencuari është i obliguar gjatë gjithë kohëzgjatjes së licencës së shërbimit të:
 - 1.1. Zbatojë legjislacionin në fuqi në Kosovë, rregulloret dhe procedurat e aprovuara nga Autoriteti;
 - 1.2. Të ofrojë shërbimet për të cilat është licencuar sipas kategorive të definuara në nenin 4, paragrafi 1 (1.1. deri 1.5.), standardeve teknike dhe kushteve të licencës të miratuara nga Autoriteti;
 - 1.3. Mirëmbajë shërbimet në përputhje me standardet minimale të specifikuara nga Autoriteti, ose me aprovim për përjashtim nga standardet, nëse lejohet;
 - 1.4. Zbatojë tarifën për shërbimet e ujit të aprovuara nga Autoriteti;
 - 1.5. Faturë të gjithë konsumatorët për shërbimet e ofruara;
 - 1.6. Zbatojë të gjitha kushtet e kontratës me konsumatorë;
 - 1.7. Përdorë të gjitha mjetet ligjore për të siguruar financimin e veprimtarive të licencuara;
 - 1.8. Mirëmbajë qëndrueshmërinë financiare, kapacitetet menaxheriale dhe operative-teknike në nivelin adekuat;
 - 1.9. Përtrijë lejet dhe aprovimet e kërkuara nga institucionet tjera, sipas kërkesës fillestare për licencim;
 - 1.10. Njoftojë Autoritetin brenda dhjetë (10) ditëve për çdo ndryshim të: emërimit dhe adresës, ndryshim të drejtuesve të Bordit dhe menaxhmentit ekzekutiv, drejtuesit teknik, kushteve të licencës dhe zonës së shërbimit;
 - 1.11. Kur drejtuesi ose menaxheri teknik është dorëhequr, përjashtuar, ose i ka kaluar kontrata, i licencuari obligohet të paraqesë njoftimin dhe dokumentet përkatëse për drejtuesin e ri teknik brenda dhjetë (10) ditëve.

Neni 15

Kriteret e veçanta për dhënien e licencës për shërbime

1. Licenca për shërbime lëshohet vetëm nëse aplikuesi ka përmbushur edhe kriteret e veçanta si më poshtë:
 - 1.1. Të mos jetë në proces likuidimi ose falimentimi;
 - 1.2. Të ketë strukturë organizative funksionale (organigram), të aprovuar nga organi më i lartë drejtues i ofruesit të shërbimeve (Bordi i Drejtorëve);
 - 1.3. Të ketë një udhëheqës apo menaxher të departamentit teknik që ka diplomë

universitare në drejtimin e inxhinierisë dhe që ka përvojë pune të paktën pesë (5) vite në sektorin e shërbimeve të ujit, pa dënime penale më të gjata se gjashtë (6) muaj;

- 1.4. Të ketë të punësuar një person ndërlidhës (person kontaktues) me përgjegjësi ekskluzive për të komunikuar me Autoritetin për të gjitha çështjet rregullatore, i cili duhet të ketë përvojë pune të paktën pesë (5) vite në sektorin e shërbimeve të ujit, pa dënime penale më të gjata se gjashtë (6) muaj;
- 1.5. Të posedojë evidencë, qoftë në kopje të fortë (letër) apo kopje elektronike, për instalimet dhe objektet tjera për ofrimin e shërbimeve për të cilat është licencuar, e që janë në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e shëndetit, sigurisë teknike dhe mjedisit;
- 1.6. Të ketë pajisje matëse të instaluara në pikat e prodhimit dhe shpërndarjes së ujit;
- 1.7. Posedon sistem efikas për leximin e ujëmatësve;
- 1.8. Të ketë sistem të organizuar për shqyrtimin, zgjidhjen dhe menaxhimin e ankesave të konsumatorëve.

KAPITULLI IV

KUSHTET E LICENCËS

Neni 16

Kushtet e të licencuarit

1. I licencuari është i detyruar të zbatojë legjislacionin në fuqi, rregullat, procedurat dhe udhëzimet e Autoritetit për sigurimin e shërbimeve në përputhshmëri me kërkesat ligjore.
2. Të licencuarit i ndalohej të transferojë licencën për ofrimin e shërbimeve një pale tjetër.
3. Të licencuarit i ndalohej të ofrojë shërbime për shitjen e ujit të pijshëm për qëllime tregtare pa miratimin paraprak të Autoritetit. Shitja e ujit për qëllime tregtare mund të realizohet vetëm përmes një marrëveshjeje të veçantë, e cila duhet të miratohet nga Autoriteti. Çdo përpjekje për të realizuar shitjen e ujit për qëllime tregtare pa këtë miratim do të konsiderohet si shkelje e rregullores dhe do të ndëshkohet në përputhje me ligjin dhe rregullat e Autoritetit.
4. Përdorimi i ujit për qëllime tregtare nuk kërkon miratim paraprak të Autoritetit deri në një vëllim maksimal prej 10,000 m³/muaj. Përtej këtij vëllimi kërkohet miratimi i veçantë sipas paragrafit 3 të këtij neni.
5. I licencuari është i obliguar ti dorëzojë Autoritetit pasqyrat financiare të audituara nga auditorët e pavarur pas finalizimit të raportit.
6. I licencuari është i obliguar t'i përmbushë të gjitha kërkesat e raportimit të përcaktuara në legjislacionin e aplikueshëm, duke përfshirë dorëzimin e raporteve dhe planeve specifike brenda afateve të caktuara ligjërisht. Këto kërkesa përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në, raportet periodike për performancën e shërbimeve, planet për mirëmbajtjen e infrastrukturës, dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga Autoriteti.
7. Në rastet kur janë të nevojshme inspektime, verifikime ose auditime, i licencuari duhet të lejojë qasje të plotë dhe të pa kufizuar në të gjitha dokumentet, objektet dhe sistemet e tij të informacionit.

Neni 17

Monitorimi dhe inspektimi i kushteve të licencës

1. Autoriteti monitoron dhe inspekton zbatimin e kushteve të licencës për të siguruar përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe kushtet e përcaktuara në licencë. Monitorimi dhe inspektimi përfshin analizën e të dhënave dhe informacionit të raportuar nga i licencuari.

2. Autoriteti është përgjegjës të kryejë inspektime për të siguruar besueshmërinë e të dhënave të raportuara. Inspektimet kryhen në përputhje me ligjin për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe aktet nënligjore të nxjerra nga Autoriteti.
3. Nëse gjatë inspektimeve ose monitorimit konstatohet se i licencuari nuk ka përmbushur obligimet e raportimit ose kushtet e licencës, Autoriteti mund të ndërmarrë masa ligjore për kundërvajtje, të përcaktuara në ligjin dhe rregulloret në fuqi.
4. Autoriteti mund të ndryshojë, plotësojë ose zëvendësojë kushtet e caktuara të licencës për shërbime dhe njofton me shkrim ofruesit të shërbimeve. Në njoftim theksohet natyra dhe shtrirja e ndryshimit, plotësimit ose zëvendësimit dhe koha e plotfuqishmërisë.

KAPITULLI IV

PROCEDURAT PËR REVOKIM, PEZULLIM DHE HEQJE DORË NGA LICENCA E SHËRBIMIT

Neni 18

Revokimi i licencës së shërbimit

1. Revokimi i Licencës për Shërbime është një veprim që realizohet me një vendim të Autoritetit dhe ndodh kur ofruesi i shërbimeve ka shkelur rëndë kushtet e licencës ose nuk ka përmbushur kërkesat ligjore.
2. Në rastin e revokimit të licencës, ofruesi i shërbimeve është i obliguar të vazhdojë ofrimin e shërbimeve për konsumatorët për një periudhë minimale prej dy (2) vitesh nga data e revokimit të licencës. Ky afat ka për qëllim të sigurojë një kalim të qetë deri në gjetjen e zgjidhjes alternative për ofrimin e shërbimeve. Gjatë kësaj periudhe niveli i standardeve të shërbimeve do të mbeten të pandryshuara duke zbatuar tarifat e shërbimeve të aprovuara nga Autoriteti.

Neni 19

Pezullimi i licencës së shërbimit

1. Autoriteti mund të pezullojë përkohësisht licencën e shërbimit për tërë zonën e shërbimit apo për një pjesë të zonës së shërbimit, nëse ofruesi i shërbimeve:
 - 1.1. Nuk ka ofruar fare shërbimet për të cilat është licencuar, sipas kategorive të definuara në nenin 4, paragrafi 1 (1.1. deri 1.5.);
 - 1.2. Nuk i ka përmbushur kushtet e licencës dhe standardet e shërbimit të përcaktuara në Rregulloret përkatëse.
2. Pezullimi do të hyjë në fuqi pas nxjerrjes së një vendimi me shkrim nga Autoriteti.
3. Pas shpalljes së vendimit për pezullim të licencës, ofruesi i shërbimeve duhet të marrë masa për të korrigjuar dështimet apo shkeljet e konstatuara nga Autoriteti, brenda një afati kohor të përcaktuar me vendim të Autoritetit nga data e pezullimit.
4. Gjatë periudhës së pezullimit, niveli i standardeve të shërbimit do të mbeten të pandryshuara, duke zbatuar tarifat e shërbimit të aprovuara nga Autoriteti. Ky paragraf aplikohet në rastet kur ofruesi vazhdon ende të ofrojë shërbimin.
5. Në rastet kur pezullimi i licencës ndodh si pasojë e neglizhencës apo mos-kujdesit nga personat përgjegjës të ofruesit të shërbimeve, Autoriteti është i detyruar të njoftojë me shkrim Ministrinë përkatëse brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pezullimit të licencës.

6. Në rast të mos korigjimit të shkeljeve të pezullimit të licencës brenda afatit të dhënë, Autoriteti do të iniciojë masën për ndryshim ose revokim të licencës së shërbimit.

Neni 20

Heqja dorë nga licenca për shërbime

1. Ofruesi publik i shërbimeve nuk mund të heq dorë nga licenca e shërbimit pa miratim paraprak të Qeverisë së Kosovës.
2. Pas miratimit paraprak sipas paragrafit 1 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve njofton me shkrim Autoritetin. Ky njoftim duhet të bëhet jo më vonë se dy (2) vite para datës së planifikuar për ndalimin e ofrimit të shërbimeve.
3. Njoftimi për heqjen dorë nga licenca duhet të përfshijë:
 - 3.1. Datën e planifikuar për ndalimin e ofrimit të shërbimeve;
 - 3.2. Arsyet për heqjen dorë nga licenca;
 - 3.3. Informacione mbi masat e marra për të siguruar një kalim të qetë dhe për të minimizuar ndikimin në konsumatorë dhe në zonën e shërbimit.
4. Ofruesi i shërbimeve është i obliguar të vazhdojë të ofrojë shërbimet sipas kushteve dhe standardeve të përcaktuara në licencë deri në datën e planifikuar për ndalimin e shërbimeve.
5. Autoriteti njofton me shkrim nivelin lokal dhe qendror për rrethanat e reja të krijuara, si dhe nevojën për ndërmarrjen e veprimeve për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve për konsumatorët.
6. Ofruesi i shërbimeve do të sigurojë operim optimal të aseteve dhe do të mbahet përgjegjës për kompensim të çdo dëmi që mund të ndodhë deri në datën e miratuar për ndalimin e ofrimit të shërbimeve, nëse konstatohet se dëmi është i qëllimshëm.

Neni 21

Taksa vjetore e licencimit

1. Lartësia e taksës vjetore të licencimit (TVL), do të përcaktohet nga Autoriteti përmes nxjerrjes së Udhëzimit Administrative për Përcaktimin e Taksës Vjetore të Licencimit. Autoriteti nxjerr Udhëzim Administrativ për Përcaktimin e Taksës Vjetore të Licencimit çdo vit, për vitin pasues kalendarik, pas hyrjes në fuqi të ligjit për ndarjet buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës.
2. Ofruesi i shërbimeve i paguan Autoritetit taksën vjetore të licencimit deri në një pikë pesë përqind (1.5%) të bruto faturimit vjetor nga veprimtaria themelore të raportuar në pasqyrën e të ardhurave të saja për vitin paraprak.
3. Taksa vjetore e licencimit duhet paguar, në llogarinë bankare të Autoritetit në dymbëdhjetë (12) këste të barabarta. Kësti i parë duhet të paguhet në ditën e parë të muajit kalendarik pas muajit në të cilin licenca për shërbime i është lëshuar ose përtëritur ofruesit të shërbimeve, kurse secili nga këstet e radhës duhet të paguhet në ditën e parë të secilit muaj pasues kalendarik.
4. Në rast se ofruesi i shërbimeve ka vonesa në pagesa të taksës vjetore të licencimit dhe nuk i përmbahet paragrafit 3 të këtij neni, Autoriteti do të aplikojë masat e nevojshme ligjore për arkëtim të TVL.

KAPITULLI VI

DISPOZITAT NDËSHKIMORE DHE KUNDËRSHTIMI

Neni 22

Masat ndëshkimore për shkelje të kushteve të licencës

1. Nëse i licencuari nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara në kushtet e licencës dhe standardet e shërbimit gjatë operimit dhe ofrimit të shërbimeve, Autoriteti do të zhvillojë hetime për të verifikuar shkeljet eventuale. Pas përfundimit të hetimeve, Autoriteti do ta njoftojë të licencuarin me shkrim.
2. I licencuari është i detyruar të bashkëpunojë me Autoritetin gjatë hetimeve për shkeljet e mundshme dhe të zbatojë çdo masë të marrë nga Autoriteti për të korrigjuar shkeljet dhe për të rivendosur përputhshmërinë me kërkesat e ligjit dhe rregulloreve.
3. Pas pranimit të njoftimit apo paralajmërimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, i licencuari është i obliguar të paraqesë një deklaratë me shkrim tek Autoriteti brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pune. Në deklaratë, ai mund të përfshijë çdo çështje që dëshiron të merret parasysh në mbrojtje të tij, siç janë faktet që mund të zbusin përgjegjësinë e tij dhe ndonjë dëshmi tjetër të rëndësishme.
4. Nëse, pas përfundimit të hetimeve të arsyshme dhe administrimit të provave, konstatohet se ka pasur shkelje të kushteve të licencës, ofruesi i shërbimeve dhe personi përgjegjës i ofruesit të shërbimeve do të dënohen për kundërvajtje në përputhje me dispozitat e Ligjit për Kundërvajtje dhe Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

Neni 23

Masat sanksionuese për shkelje të dispozitave ligjore dhe kushtet e licencës

1. Në rast të shkeljeve të dispozitave ligjore dhe kushteve të licencës, Autoriteti mund të shqiptojë masa sanksionuese në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në varësi të shkeljeve. Këto masa përfshijnë:
 - 1.1. Pezullimin e Licencës;
 - 1.2. Revokimin e Licencës;
 - 1.3. Shqiptimi i gjobës për kundërvajtje dhe aplikimin e masave të tjera administrative siç parashikohet në ligj.
2. Këto masa do të merren në përputhje me kushtet dhe procedurat të përcaktuara në rregulloren përkatëse dhe ligjin në fuqi.

Neni 24

Kundërshtimet dhe ankesat

1. Ofruesi i shërbimeve, personi përgjegjës i ofruesit të shërbimeve ndaj të cilit është lëshuar vendimi për masa apo sanksione lidhur me shkeljet, mund të parashtrojë kundërshtim apo ankesë, sipas afatit të përcaktuar me Ligjin për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, dhe Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
2. Çdo vendim apo veprim i Autoritetit, i cili është marrë në bazë të ligjeve i nënshtrohet shqyrtimit administrativ dhe atij gjyqësor, në përputhje me kushtet dhe procedurat e

parapara në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjin për Konfliktet Administrativ.

KAPITULLI VII

DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 25 Gjuha zyrtare

Kjo Rregullore është nxjerrë në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare në Republikën e Kosovës.

Neni 26 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohen Rregullorja Nr. 05/2016 për Licencimin e Ofruesve të Shërbimevetë Ujit në Kosovë.

Neni 27 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hynë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit nga Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbime të Ujit, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të Autoritetit.

Datë __.11.2024
Prishtinë

Drejtori i ARRU

Hajrije MORINA

Shtojca 1: Lista e dokumenteve për aplikim të licencës së shërbimit

Lista e dokumenteve që duhet bashkangjiten aplikacionit për licencë të shërbimeve

1. Certifikata e biznesit;
2. Dëshmi për kushtet higjiene – sanitare, lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;
3. Dëshmi nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës për kualitetin e ujit;
4. Leje për shfrytëzimin e burimeve të ujit;
5. Leje për shkarkimin e ujërave të ndotura;
6. Marrëveshja për shërbime me komunat përkatëse;
7. Pasqyrat financiare vjetore të audituara;
8. Përshkrimi i shkurtër i tekstual, përfshirë hartat, që paraqesin:
 - 8.1. Zonën e shërbimit sipas vendbanimeve;
 - 8.2. Objektet e përpunimit, deponimit dhe pompimit të ujit;
 - 8.3. Burimet e ujit;
 - 8.4. Rrjeti kryesor dhe shpërndarës i ujit;
 - 8.5. Objektet e përpunimit të ujërave të ndotura;
 - 8.6. Rrjeti i kanalizimit;
 - 8.7. Pikat e shkarkimit të ujërave të ndotura (efluentëve);
9. Autorizimi nga organi më i lartë i udhëheqjes (Bordi i Drejtorëve) për personin, të cilit i është dhënë e drejta për të kryer të gjitha aktivitetet për aplikim të marrje së licences; dhe
10. Deklarata e aplikuesit.

Shtojca 2: Forma e aplikacionit për licencë të shërbimit

KËRKESË PËR LICENCIM, PËRTËRITJE, DHE NDRYSHIM TË LICENCËS

Emërtimi i Aplikuesit: _____

Adresa e Plotë e Aplikuesit: _____

Numri i Telefonit / Email-i i Aplikuesit: _____

1. Lloji i Aplikacionit (Shenjat me 'X' për shërbimin e kërkuar):

1.1. Licencim për herë të parë

1.2. Përtëritje/vazhdim i licencës eksistuese

1.3. Ndryshim i Licencës për shkak të ndryshimeve

2. Kategoria e Shërbimeve për Aplikim (Përzgjidh me 'x' kategorinë e shërbimit):

2.1. Kategoria A: Shërbimet e Ujësjiellit

2.2. Kategoria B: Shërbimet e Kanalizimit

2.3. Kategoria C: Shërbimet e Ujërave të Ndotura

2.4. Kategoria D: Shërbimet e Ujit, me Shumicë, të Papërpunuar

2.5. Kategoria E: Shërbimet e Ujit, me Shumicë, të Përpunuar

2.3. Kategoria C: Shërbimet e Ujërave të Ndotura

3. Informacion Shtesë për Aplikimin:

3.1. Shpjegim të Shërbimeve të Kërkuara: [Ju lutemi, ofroni një përshkrim të hollësishëm të shërbimeve për të cilat po aplikoni].

3.2. Përshkrim i Ndryshimeve (nëse aplikohet për ndryshim): [Shpjegoni ndryshimet që do të bëhen në licencën ekzistuese].

3.3. Dokumentet e Bashkëngjitura: [Lista e dokumenteve që po dërgohen së bashku me aplikacionin].

4. Deklarata e Aplikuesit:

Nën përgjegjësinë time të plotë ligjore, deklaroj se të dhënat dhe informacionet e paraqitura në këtë aplikacion dhe në dokumentet e bashkëngjitura janë të vërteta, të sakta dhe në përputhje me kërkesat e parashikuara nga Rregullorja për Licencim të lëshuar nga Autoriteti Rregullator i Shërbimeve të Ujit. Zotohem që do të ndjek me përpikmëri zbatimin e akteve ligjore, akteve nënligjore të nxjerra nga Autoriteti, si dhe kushtet e licencës. Shtojca 3: Forma e formularve që duhet të plotësohen me të dhëna për kategoritë e shërbimeve A, B, C, D, E.

Data: _____

Emri mbiemri dhe pozita e punës e personit të autorizuar

Vendi: _____

Nënshkrimi

Shtoca 3: Formularët me të dhëna bazë sipas kategorive të shërbimeve; A, B, C, D, E

FORMULARI PËR KATEGORINË ‘A’

1. Zona e shërbimit (territori dhe popullata e shërbyer):

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit				
Komunat [Emërtimi i komunave që do të ju ofrohen shërbimet]	Listo Zonat urbane (qyteti) dhe zonat rurale (fshatrat) [Në kolonën A të emrtohet vendbanimi, ndërsa në kolonën B numri i banorëve]		Kërkesa e vlerësuar për ujë [Llogarit kërkesën për ujë, m3/vit]	Kapaciteti i resurseve ekzistuese [m3/vit]
	A	B		
<i>Gjakovë¹</i>	<i>Qyteti</i>	<i>70,000</i>	<i>3,832,500</i>	<i>3,800,000</i>
	<i>Bardhaniq</i>	<i>2,500</i>		
	<i>Batusha</i>	<i>3,000</i>		
	<i>etj.</i>			
<i>Rahovec</i>	<i>Qyteti</i>	<i>40,000</i>		
	<i>Zoqisht</i>			
	<i>Opterushë</i>			
	<i>etj.</i>			
<i>Prizren</i>	<i>Lubizhdë</i>			
	<i>Krushë</i>			
	<i>etj.</i>			

2. Burimet e ujit:

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit				
Emërtimi i vendburimit	Vendndodhja	Lloji [pus, burim, liqe, lum]	Vëllimi i kaptimit, m3/vit	Kapaciteti shfrytëzues, m3/vit

3. Trajtimi i ujit:

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit				
Emërtimi i Impiantit	Vendndodhja	Lloji i trajtimit (fizik, biologjik, kimik)	Kapaciteti maksimal, m3/vit	Kapaciteti shfrytëzues, m3/vit

^{t1} Shënimet me ngjyrë të kuqe shërbejnë si shembuj.

				Totali

4. Objektet për deponimin e ujit të trajtuar:

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit		
Emërtimi rezervuarit	Vendndodhja	Kapaciteti rezervues, m ³
		Totali

5. Stacionet e pompimit

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit		
Emërtimi stacionit pompues	Vendndodhja	Kapaciteti rezervues, m ³
		Totali

6. Cilësia e ujit të trajtuar:

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit		
Emërtimi burimit	Lloji i analizave	% e përmbushjes së standardeve <i>[analizat e verifikuara nga IKSHKP]</i>
	Analizat bakteriologjike	
	Analizat kimike	

7. Personeli:

Kategoria A: Shërbimet e ujësjellësit
Numri i punëtorëve me orar të plotë për këtë shërbim

FORMULARI PËR KATEGORINË 'B'

I. Zona e shërbimit:

Kategoria B: Shërbimet e kanalizimit	
Komunat: <i>[Emërtimi i komunave që do të ju ofrohen shërbimet në kohën e marrjes së licencës]</i>	Listo Zonat urbane (qyteti) dhe zonat rurale (fshatrat)

II. Personeli:

Kategoria B: Shërbimet e kanalizimit
Numri i punëtorëve me orar të plotë për këtë shërbim

FORMULARI PËR KATEGORINË ‘C’

I. Zona e shërbimit:

Kategoria C: Shërbimet e ujërave të ndotura	
Komunat <i>[Emërtimi i komunave, ujërat e ndotura të së cilës do të trajtohen]</i>	Zona urbane (qyteti) dhe zonat rurale (fshatrat) <i>[Emërtimi i fshatrave, ujërat e ndotura të së cilës do të trajtohen. Të listohen fshatrat brenda komunave përkatëse]</i>

II. Trajtimi i ujërave të ndotura:

Kategoria C: Shërbimet e ujërave të ndotura			
Emërtimi i Impiantit	Vendndodhja	Lloji i trajtimit (fizik, biologjik, kimik)	Kapaciteti maksimal, m ³ /vit

III. Cilësia e ujërave të ndotura të trajtuara:

Kategoria C: Shërbimet e ujërave të ndotura		
Emërtimi i Impiantit	Lloji i parametrave	% e përmbushjes së parametrave <i>[analizat e verifikuara nga MMPH]</i>
	Nevoja biokimike për oksigjen (eng. BOD)	
	Nevoja kimike për oksigjen (eng. COD)	

IV. Personeli:

Kategoria C: Shërbimet e ujërave të ndotura
Numri i punëtorëve me orar të plotë për këtë shërbim

FORMULARI PËR KATEGORINË 'D'

I. Entiteti përfitues:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar		
Emërtimi, Vendndodhja/Adresa	Kërkesa e vlerësuar për ujë, m3/vit	Validiteti i kontratës <i>[shëno datën e fillimit dhe përfundimit të kontratës]</i>

II. Burimet e ujit:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar				
Emërtimi	Vendndodhja	Lloji <i>[pus, burim, liqe, lum]</i>	Vëllimi i kaptimit, m3/vit	Kapaciteti shfrytëzues, m3/vit

III. Objektet për rezervimin e ujit, me shumicë, të papërpunuar:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar		
Emërtimi	Vendndodhja	Kapaciteti rezervues, m3
Totali		

IV. Personeli:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të papërpunuar
Numri i punëtorëve me orar të plotë për këtë shërbim

FORMULARI PËR KATEGORINË 'E'

I. Entiteti përfitues:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar		
Emërtimi, Vendndodhja/Adresa	Kërkesa e vlerësuar për ujë, m3/vit	Validiteti i kontratës <i>[shëno datën e fillimit dhe përfundimit të kontratës]</i>

II. Burimet e ujit:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar				
Emërtimi	Vendndodhja	Lloji <i>[pus, burim, liqe, lum]</i>	Vëllimi i kaptimit, m3/vit	Kapaciteti shfrytëzues, m3/vit

III. Trajtimi i ujit:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar				
Emërtimi i Impiantit	Vendndodhja	Lloji i trajtimit <i>[fizik, biologjik, kimik]</i>	Kapaciteti maksimal, m3/vit	Kapaciteti shfrytëzues, m3/vit
Totali				

IV. Objektet për rezervimin e ujit, me shumicë, të përpunuar:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar		
Emërtimi	Vendndodhja	Kapaciteti rezervues, m3
Totali		

V. Cilësia e ujit, me shumicë, të përpunuar:

Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar

Emërtimi i Impiantit	Lloji i analizave	% e përmbushjes së standardeve <i>[analizat e bëra nga IKSHPK]</i>
	Analizat bakteriologjike	
	Analizat kimike	

VI. Personeli:**Kategoria D: Shërbimet e ujit, me shumicë, të përpunuar****Numri i punëtorëve me orar të plotë për këtë shërbim**

--

Shtojca 4: Forma e Licencës të Shërbimit



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosova

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



**LICENCË PËR SHËRBIME
USLUŽNOJ DOZVOLI
SERVICE LICENSE**

I Licencuari:
Licencës:
Licencirani
Licensee

Numri i
Broj Dozvole
License Number

Adresa e të Licencuarit:
Adresa Licenciranog
Address of Licensee

Aktivitetet e licencuara:
Licencirane aktivinosti
Licensed activities

Data e lëshimit:
Datum izdavanja
Date of issue

Zona e shërbimit: **Komunat/Opštine/Municipalities**
Uslužna Zona:
Service Area:

Kushtet e përgjithshme:

Kjo Licencës për shërbime lëshohet në përputhje me Ligjin Nr.05/L-042. Kushtet e licencës, sipas tekstit të bashkangjitur, janë pjesë e pandarë e kësaj Licence. I licensuari në ushtrimin e aktivitetit të tij, vepron në pajtim me kushtet e përcaktuara të Licencës.

Opšti uslovi:

Ova usluge dozvola izdata u skladu sa Zakonom br.05 / L-042 . Uslovi dozvole, prema tekstu u prilogu, čine sastavni deo ove Licence. Licencirani u vršenju svoje delatnosti, deluje u skladu sa uslovima postavljene Licence.

General terms and conditions:

This service license is issued in accordance with Law No.05 / L-042. Terms of the License, according to the text attached, are an integral part of this License. Licensee in performing its activity, acts in accordance with the conditions set in this License.

Prishtinë, d/m/v
[vula e Autoritetit]

Në emër të Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit

U ime Regulatorni Autoritet za Usluge Vode